

Hapet Thirrja për Bursa për Stafin Akademik për mësimdhënie në Universitetin Huelva, Spanjë në Kuadër të Programit Erasmus + për vitin akademik 2017-2018

Në kuadër të Programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për stafin akademik të Universitetit të Tiranës në Universitetin Huelva, në Spanjë.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Mësimdhënie për stafin akademik

Kohëzgjatja e mobilitetit:

- 5 ditë + 2 ditët e udhëtimit;

Fushat e studimit:

Për t'u njohur me katalogun e programeve të studimit të ofruara nga Universiteti Huelva, klikoni në adresën:

<http://www.uhu.es/english/erasmusplusincoming/doc/DELEX.pdf>

Info e përgjithshme:

<http://uhu.es/english/erasmusplusincoming/>

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin ditor 120 Euro;
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni link-ut:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- CV+ lista e publikimeve (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Letër motivimi (në gjuhën angleze);
- Vërtetim Punësimi (në gjuhën shqipe);
- Certifikata e gjuhës së huaj që vërteton njohuritë e gjuhës angleze/spanjolle në vartësi të programit të studimit në nivelin B2;
- Plani i mobilitetit për mësimdhënie*;

**Mobility Plan është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar aktivitetet që do të zhvillohen gjatë periudhës së mobilitetit. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus + Z. Elton Skendaj.*

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit klikoni në adresën:
http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Teaching_Mobility_Plan.pdf

Afati për aplikim: **15 Prill 2017**

Dokumentet duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Komunikimit, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin iro@unitir.edu.al me subjekt: “Aplikim për bursë në Universitetin e Huelva, emrin dhe mbiemrin tuaj”.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën:
iro@unitir.edu.al

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikim!